



Datë: 10.04.2025

Numër Protokolli: 2390/2025

A.nr.365/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.365/2025, të datës 25.02.2025, të parashtruar nga ankuesja A.L, kundër organit: Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.365/2025, e datës 25.02.2025, e parashtruar nga ankuesja A.L

II. Ndryshohet dhe Plotësohet arsyetimi i Njoftimit të datës 11.02.2025 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me anulimin e konkursit me numër Referencë RN00016008 për pozitën “*Zyrtar i lartë për ndihmë shtetërore*”, sipas pikëpamjeve juridike të dhëna si në arsyetimin e Vendimit të Këshillit.

III. Shfuqizohet Njoftimi i datës 04.02.2025 i Njesisë së Burimeve Njerëzore, ndërsa **Anulohet** në tërësi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 10.12.2024 me numër të Referencës RN00016009 për pozitën “*Zyrtar i lartë për vlerësimin e ndihmës shtetërore*” në Ministrinë së Financave, Punës dhe Transfereve.

IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së, që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **III** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, A.L (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 25.02.2025, përmes emailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-org.net, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.365/2025, kundër procedurës së rekrutimit me shifër RN00016009 për pozitën Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Ndihmës Shtetërore dhe kundër procedurës së rekrutimit me shifër RN00016008 për pozitën Zyrtar i Lartë për Ndihmë Shtetërore të shpallura nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 03.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (tutje MFPT), ndërsa kjo e fundit, me datë 14.03.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës, si dhe me datë 26.03.2025 ka dhënë prova dhe sqarime shtesë sipas kërkesës së Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1215/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 25.02.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 10.12.2024 me shifër RN00016009; Njoftimin e datës 23.01.2025; Njoftimin e datës 23.01.2025; Lista përfundimtare e kandidatëve të suksesshëm e datës 04.02.2025; Konkursin e datës 10.12.2024 me shifër RN00016008; Njoftimin e datës 14.01.2025; Njoftimin e datës 24.01.2025; Njoftimin e datës 03.02.2025; Njoftimin e datës 04.02.2025; Lista përfundimtare e datës 11.02.2025; Njoftimin e datës 18.10.2024; Lista përfundimtare e vlerësimit e datës 12.11.2024; Kopja e letërnjoftimit të ankueses; E-mailin e datës 25.02.2025 dërguar nga ankuesja për Këshillin; Formularin e regjistrimit të ankesës; Kërkesa për përgjigje në ankesë 03.03.2025; Përgjigja e datës 14.03.2025; E-mail i datës 04.12.2024 dërguar nga A.A për L.K dhe të tjerët; Aplikacionin e ankueses të datës 26.12.2024 për konkursin RN00016009; Aplikacionin e ankueses për konkursin RN00016008; Lista përfundimtare e datës 04.02.2025; Lista e aplikantëve e datës 03.02.2025 në konkursin RN00016008; Formularin i renditjes përfundimtare; E-mail i datës 05.02.2025; E-mailin e datës 20.01.2025; E-mailin e datës 24.01.2025 dërguar nga M.Q për M.Q; Vendimin e datës 20.01.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimit me akt emërimet e anëtarëve.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se MFPT, më datë 10.12.2024 ka shpallur konkursin me numër reference RN00016008, për Grupin e Ekonomisë, pozita “Zyrtar i Lartë për Ndihmë Shtetërore- Profesional I”, numri i kërkuara 2, në Departamentin e Kontrollit të Ndihmës Shtetërore, ku afati për aplikim ka qenë nga data 11.12.2024 deri më 09.01.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, në këtë konkurs kanë aplikuar 65 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesja, ndërsa prej tyre verifikim paraprak e kanë kaluar vetëm 15 kandidatë, ndërsa ankueses i ishte refuzuara aplikacioni i saj.

Pas përfundim të fazave të vlerësimit të testit me shkrim, Njësia e Burimeve Njerëzore e MFPT-së, më datë 24.01.2025, ka publikuar njoftimin përmes së cilit bëhet e ditur se është anuluar testi me shkrim, ndërsa procedura e rekrutimit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë është kthyer në fazën e verifikimit paraprak, me arsyetimin se, citoj: “.. *gjatë fazës së verifikimit paraprak janë identifikuar disa raste të cilat nuk kanë qenë në përputhje me grupin i cili është përcaktuar në konkurs e që është Grupi i ekonomisë*”. Tutje, pas kthimit të procedurës së rekrutimit në fazën e verifikimit paraprak, Njësia e Burimeve Njerëzore, përmes Njoftimit të datës 03.02.2025 ia ka refuzuar aplikacionin ankueses me arsyetimin se i **mungon kriteri i kërkuar i kualifikimit Ekonomik**, sipas kërkesave të përgjithshme të konkursit, ndërsa sipas Njoftimit të datës 11.02.2025 është bërë e ditur se procedura e rekrutimit ka përfunduar pa kandidatë fitues, respektivisht konkursi është anuluar për shkak se asnjëri nga kandidatët që i është nënshtruar testimit me shkrim nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 7 të Rregullores 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil si dhe nenin 9 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe duke u bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimi me Nr. reference RN00016008, për **Grupin e Ekonomisë**, pozita “Zyrtar i Lartë për Ndihmë Shtetërore” ka konstatuar se për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor)*; **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*”.

Kolegji i Këshillit përpara se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit, mori përbazë Vendimin Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku përmes pikës I të dispozitivit është aprovuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ndërsa sipas pikës 6 të dispozitivit të të njëjtit vendim përcaktohet fakti se vendimi në fjalë hynë në fuqi ditën e publikimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe për rrjedhojë u konstatua fakti se Vendimi Nr.08/226 i datës 23.10.2024 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është publikuar në gazetën zyrtare me datë 23.10.2024, nga rrjedh se i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024, ndërsa konkursi në fjalë është shpallur pasi ka hyrë në fuqi Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, përkatësisht më datë 10.12.2024.

Duke marrë përbazë Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, të aprovuar sipas Vendimit Nr.08/226 të datës 23.10.2024, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita me emërtimin “Zyrtar i Lartë për Ndihmë Shtetërore”, nuk është e identifikuar në katalogë, dhe meqenëse emërtimi i pozitës apo pozita në fjalë nuk figuron në katalogun e vendeve të punës, Kolegji i Këshillit iu referua kriterëve të Grupit të Ekonomisë.

Në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozitat e aplikuara të nenit 19, si dhe nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: “19. Kërkesat e përgjithshme formale, **përfshijnë arsimin, përvojën e punës**

profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi; 30.1. Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike. 30.2. **Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.**”, konstatoi se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve shpalljen e konkursit RN00016008 të datës 10.12.2024 për pozitën “Zyrtar i Lartë për Ndihmë Shtetërore” e kanë bërë në kundërshtim me Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, i aprovuar dhe i cili ka hy në fuqi me datë 23.10.2024 sipas Vendimin Nr.08/226 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me dispozitat e cekura si më lartë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojcën Nr.2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, pasi që sipas katalogut, për pozitën në Grupin e Ekonomisë është i përcaktuar fusha e kualifikimit arsimor-**Ekonomi (pavarësisht nga specializimi)**, ndërsa sipas konkursit të datës 10.12.2024 ishte përcaktuar si kriter i kualifikimit arsimor vetëm Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), nga rrjedh se ua kanë mundur fillimisht që të gjitha ata që kanë një diplomë bachelor, pavarësisht fushës së studimit të aplikojnë në këtë procedurë të rekrutimit, ndërsa më pastaj ua kanë refuzuar aplikacionet sikurse në rastin e ankueses ku përmes Njoftimit të datës 03.02.2025 të njëjtës i ishte refuzuar aplikacioni me arsyetimin se i mungon kriteri i kërkuar i kualifikimit në Ekonomi, nga rrjedh se procedura e rekrutimit me rastin e hapjes së konkursit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me nenin 19 dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Thënë si më lartë konkursi në fjalë është anuluar në tërësi për shkak të paligjshmërisë së tij, prandaj Njoftimi i datës 11.02.2025 përmes të cilit është anuluar konkursi me arsyetimin se asnjëri nga kandidatët e suksesshëm nuk e ka kaluar testin me shkrim, ne rrethanat e rastit konkret ky arsyetim nuk mund të gjej vend, pasi që Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, këtë konkurs është dashur ta anuloi për shkak shpalljes së tij në kundërshtim me nenin 19 dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, prandaj arsyetimi vendimit të Këshillit shërben si plotësim ndryshim i arsyetimit të Njoftimit të datës 11.02.2025 të Njësisë së Burimeve Njerëzore lidhur me anulimin e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016008, pozita Zyrtar i Lartë për Ndihmë Shtetërore.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se meqenëse konstatoi paligjshmërinë e aktit të shpalljes së konkursit në fjalë, nuk u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesën e datës 25.02.2025, pasi që konstatimi nëse pretendimet janë apo jo të bazuara nuk do ta ndryshonin natyrën vendimmarrëse të kësaj çështje administrative, ndërsa ankesa e ankueses është aprovuar vetëm për arsyet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Po ashtu, nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se MFPT, më datë 10.12.2024 ka shpallur konkursin me numër reference RN00016009, për Grupin e Ekonomisë, pozita “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Ndihmës Shtetërore- Profesional I”, numri i kërkuar 2, në Departamentin

e Kontrollit të Ndihmës Shtetërore, ku afati për aplikim ka qenë nga data 11.12.2024 deri më 09.01.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, në këtë konkurs fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar vetëm 13 kandidatë, ndërsa ankueses i ishte refuzuara aplikacioni i saj.

Tutje, Njësia e Burimeve Njerëzore, përmes Njoftimit të datës 23.01.2025 ia ka refuzuar aplikacionin ankueses me arsyetimin se i mungon kualifikimi arsimor sipas kërkesave të përgjithshme të konkursit, pa përcaktuar qartë se për cilin kualifikim bëhet fjalë, përderisa sipas konkursit në fjalë, nuk kishte të përcaktuar fushë specifike të kualifikimit arsimor por kërkohej vetëm Diploma e nivelit të parë bachelor, ndërsa sipas Njoftimit të datës 04.02.2025 rezulton si kandidate fituese, kandidatja L.S me gjithsejtë 88.2 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se procedurat e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 7 të Rregullores 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil si dhe nenin 9 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe duke u bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimit me Nr. reference RN00016009, për **Grupin e Ekonomisë**, pozita “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Ndihmës Shtetërore” ka konstatuar se për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor); Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës**”.

Kolegji i Këshillit përpara se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit, mori përbazë Vendimin Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku përmes pikës 1 të dispozitivit është aprovuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ndërsa sipas pikës 6 të dispozitivit të të njëjtit vendim përcaktohet fakti se vendimi në fjalë hynë në fuqi ditën e publikimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe për rrjedhojë u konstatua fakti se Vendimi Nr.08/226 i datës 23.10.2024 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është publikuar në gazetën zyrtare me datë 23.10.2024, nga rrjedh se i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024, ndërsa konkursi në fjalë është shpallur pasi ka hyrë në fuqi Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, përkatësisht më datë 10.12.2024.

Duke marrë përbazë Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, të aprovuar sipas Vendimit Nr.02/226 e të datës 23.10.2024, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Ndihmës Shtetërore, klasa Profesional 1, identifikohet me kodin SHC-0876 në kuadër të grupimit **Grupi i shkencave shoqërore**, kurse fusha e kërkuara e arsimit përcaktohet të jetë: **Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike**.

Në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozitat e aplikuara të nenit 19, si dhe nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin

Civil ku përcaktohet se: “19. *Kërkesat e përgjithshme formale, **përfshijnë arsimin**, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi;* 30.1. *Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike.* 30.2. **Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.**”, konstatoi se Ministria e Financave shpalljen e konkursit RN00016009 të datës 10.12.2024 për pozitën “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Ndihmës Shtetërore” e ka shpallur në kundërshtim me Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, i aprovuar dhe i cili ka hy në fuqi me datë 23.10.2024 sipas Vendimit Nr.08/226 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me dispozitat e cekura si më lartë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojcën Nr.2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, pasi që pozita në fjalë “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Ndihmës Shtetërore” hynë në kuadër të grupimit **Grupi i shkencave shoqërore**, ndërsa sipas konkursit pozita në fjalë është përfshirë në grupin **Grupi i ekonomisë**, dhe për rrjedhojë pozitës në fjalë i janë ndryshuar edhe kriteret e përcaktuara të kualifikimit arsimor të cilat janë të përcaktuara sipas rregullores së lartcekur dhe Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, nga rrjedh se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me nenin 19 dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se në këtë procedurë të rekrutimit shkeljet janë evidentuar qysh me rastin e shpalljes së konkursit të datës 10.12.2024, ashtu që nuk janë përfillur kriteret e aprovuara lidhur me grupimin e pozitës, duke ndryshuar më pastaj edhe kriteret për fushën e kualifikimit arsimor për pozitën *Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Ndihmës Shtetërore*, duke u bazuar në dispozitat e nenit 53 dhe nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi që të anuloi konkursin e datës 10.12.2024 me numër të Referencës RN00016009 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Ndihmës Shtetërore* në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe të shfuqizoi çdo akt dhe veprim tjetër procedural që ndërlidhet me konkursin në fjalë.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se meqenëse konstatoi paligjshmërinë e aktit të shpalljes së konkursit në fjalë, nuk u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesën e datës 25.02.2025, pasi që konstatimi nëse pretendimet janë apo jo të bazuara nuk do ta ndryshonin natyrën vendimmarrëse të kësaj çështje administrative, ndërsa ankesa e ankueses është aprovuar vetëm për arsyet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 21 paragrafi 1 dhe nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, ku përcaktohet se: “21.1. *Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi*

përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës; 24.1. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.”, në rast se Vendimi i Këshillit nuk zbatohet sipas dispozitivit të përcaktuar, ndaj personit përgjegjës i përcaktuar në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi, do të merren masa përkatëse në pajtim me nenin 24 paragrafi 1 të të njëjtit ligj.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.365/2025, datë 10/04/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses A.L;
- Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.